



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM  
Nr. 73 datë 19.12.2024**

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROGRAMIT  
BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 DHE BUXHETIT VJETOR 2026”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 33 të ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit Nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, udhëzimit Nr. 23 datë 30.07.2018 “Per procedurat standarde të përgatitjes së programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të qeverisjes vendore”, të ndryshuar, udhëzimit Nr. 9 datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, si dhe dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026, sipas lidhjes Nr. 1, bashkangjitur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 29 vota  
Vota Pro 29  
Vota Kundër 16  
Vota Abstenim 0  
Zbardhur me datë 20.12.2024

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**



**KRYETAR**

**Oltion LULI**



**Kalendari PBA & buxhetit vjetor**

- Përgatitet nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe i propozohet më tej Këshillit të njësisë;
- Miratohet nga këshilli i njësisë;
- Hyn në fuqi dhe shpërndahet te të gjitha njësitë shpenzuese nga kryetari i njësisë (Janar 2025).

**Vlerësimet dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve**

- Kryetari paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshill (brenda 31.01. viti 2025);
- Këshilli miraton raportin e vlerësimeve (1.03. viti 2025).

**Tavanet e shpenzimeve të PBA në nivelin e programit**

- Kryetari i njësisë propozon tavanet përgatitore për miratim në këshill (1.03. viti 2025);
- Këshilli miraton tavanet përgatitore (15.03. viti 2025);
- Kryetari i njësisë miraton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit (5 ditë nga miratimi i tavanëve);
- Udhëzimi shpërndahet te njësitë shpenzuese (5 ditë nga miratimi i tavanëve / 20.03. viti 2025);
- Tavanet përfundimtare paraqiten nga kryetari i njësisë në këshill (korrik viti 2025);
- Këshilli miraton tavanet përfundimtare (20.07. viti 2025);
- Kryetari i njësisë nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë dhe e shpërndan te të gjitha njësitë shpenzuese (5 ditë nga miratimi i tavanëve përfundimtare / 25.07. viti 2025).

**Kërkesat sipas tavanëve**

- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda tavanëve përgatitore te Njësia e Menaxhimit të Programeve (prill viti t) dhe japin argumente për fonde tavanë shtesë.
- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brenda tavanëve përfundimtare (1.08. viti 2025).

**PBA & Buxheti vjetor**

- Kryetari i njësisë përgatit dokumentin I të PBA viti t-1, t-2, t-3 (30.05.2025)
- Kryetari i njësisë dërgon MFE PBA (1.06. viti 2025); •MFE-ja dërgon opinionin e saj mbi PBA-në te njësia vendore (20.06. viti 2025);
- Kryetari i njësisë vendore dërgon PBA-në së bashku me opinion e MFE-së për miratim në Këshill (21.06. viti 2025);
- Këshilli i njësisë vendore miraton dokumentin e parë të PBA-së (30.06. viti 2025);
- Kryetari publikon PBA / dokumentin I (5.07 viti 2025);
- MFE-ja nxjerr udhëzimin plotësues për rishikimin e PBA-së (10. korrik viti 2025);
- Njësia rishikon PBA-së (korrik - gusht viti 2025);
- Njësia organizon takime konsultuese (1-15.09. viti 2025);
- Njësia dërgon PBA-në e rishikuar te MFE-ja 15.09.2025
- MFE-ja zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore (5.10.2025);
- MFE-ja dërgon opinionin përfundimtar sipas rastit te njësia vendore (20.10.2025);
- Kryetari i bashkisë paraqet për miratim në Këshill PBA-në dhe buxhetin vjetor përfundimtar (30.11.2025);
- Këshilli miraton PBA-në dhe buxhetin vjetor (25.12.2025);
- Kryetari i njësisë publikon PBA-në dhe buxhetin vjetor dhe materialet shoqëruese (31.12.2025).